

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-10415

Më 25.9.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 25.9.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës - Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike për iniciimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të ish objektit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës - Rektoratit të Universitetit të Prizrenit, dhe mori këtë:

#### K O N K L U Z I O N

I. Lejohet iniciimi i procedurave për dhënien në shfrytëzim të ish objektit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës - Rektoratit të Universitetit të Prizrenit.

II. Obligohet Drejtoria e Administratës- Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike që, pas marrjes së këtij konkluzioni, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Administratës- Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Administratës- Sektori për Çështje Pronësore dhe Juridike, Komisioni për Pronë, KPF-ja, Kuvendi i Komunës, Rektorati i Universitetit të Prizrenit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-10415

Më 25.9.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 25.9.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës-Sektorit i Pronës, bazuar në kërkesën e Shoqatës së Pavarur të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, për dhënien në shfrytëzim të një lokali-zyre në pronësi të Komunës, me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve të tyre dhe mori këtë:

#### K O N K L U Z I O N

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës-Sektorit i Pronës, bazuar në kërkesën e Shoqatës së Pavarur të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, për dhënien në shfrytëzim të një lokali-zyre në pronësi të Komunës, me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve të tyre. Kështu që, Shoqatës së Pavarur të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës i jepet në shfrytëzim të përkohshëm zyra që është në pronësi të Komunës së Prizrenit, e cila gjendet në ndërtesën e ish Drejtorisë për Financa, dhe atë me qira mujore prej 1 €.

II. Obligohet Drejtoria e Administratës - Sektorit i Pronës që të përpilojë kontratën mbi dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të lokalit-zyrës së lartcekur sipas nenit I të këtij konkluzioni.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Administratës-Sektorit i Pronës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Administratës-Sektorit i Pronës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-10415  
Më 25.9.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 25.9.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës rreth lejimit të shpalljes së tenderit për renovimin e pjesës së dytë të Qendrës për Shërbim të Qytetarëve, pjesa e Administratës (zyrat e Drejtorisë së Inspektorateve, të Turizmit, zyrat për Komunitete), dhe mori këtë:

### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës rreth lejimit të renovimit të pjesës së dytë të Qendrës për Shërbim të Qytetarëve, pjesa e Administratës (zyrat e Drejtorisë së Inspektorateve, të Drejtorisë së Turizmit, zyrat për Komunitete, etj.), kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Ky projekt do të realizohet në bashkëfinancim dhe në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës së Prizrenit dhe USAID-DEMI.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, USAID-DEMI, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-10415  
Më 25.9.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës-Zyra për Çështje Gjinore, të datës 17.9.2012, rreth lejimit të mjeteve për përkrahje financiare për OJQ “Femra për Femrat”, kryetari i Komunës më 25 shtator 2012, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës-Zyra për Çështje Gjinore, i datës 17.9.2012, rreth lejimit të mjeteve për përkrahje financiare për OJQ “Femra për Femrat”, me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve të tyre, përkatësisht për mbulimin e shpenzimeve për material për punë dore, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në shumën prej 500 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtorja e Administratës - Zyra për Çështje Gjinore dhe Drejtorja e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtorja e Administratës - Zyra për Çështje Gjinore, Drejtorja e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-10415  
Më 25.9.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës - Zyra për Çështje Gjinore për formimin e Këshillit monitorues për përcjelljen e realizimit të aktiviteteve të Planit të Veprimit për Barazi Gjinore për Komunën e Prizrenit, kryetari i Komunës, më 25 shtator 2012, miratoi këtë:

#### A K T V E N D I M

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës - Zyra për Çështje Gjinore për formimin e Këshillit monitorues për përcjelljen e realizimit të aktiviteteve të Planit të Veprimit për Barazi Gjinore për Komunën e Prizrenit. Për anëtarë të këtij komisioni, emërohen: 1. Shpresa Uka, nga Komiteti për Barazi Gjinore, 2. Cen Fanaj, kuvendar i KK-së-anëtar i KBGJ, 3. Xhengiz Xhurgjealo, zyrtar nga Komuna, 4. Drita Krasniqi, nga OJQ "Oaza", 5. Lule Abdiq, nga OJQ "Dora-Dorës", 6. Memnuna Ajdini, nga OJQ "Kljuc", dhe 7. Drita Vukshinaj, nga OJQ "Femra për Femra".

II. Detyrat e këshillit do të jenë: Përcjellja e realizimit të aktiviteteve të Planit të Veprimit për Barazi Gjinore për Komunën e Prizrenit, vlerësimi i përmbushjes së qëllimeve të këtij Plani etj.

III. Ky Këshill, për punën e bërë, do të raportojë kohë pas kohe me shkrim para organeve kompetente.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi në organet kompetentet të Komunës.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtorja e Administratës -Zyra për Çështje Gjinore dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen Drejtorja e Administratës -Zyra për Çështje Gjinore, të emëruarit dhe Arkivi.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-10415  
Më 25.9.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 25.9.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të datës 17.9.2012, rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për studimin e fizibilitetit të trafikut urban në Komunën e Prizrenit, dhe mori këtë:

### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 17.9.2012, rreth lejitimit të studimit të fizibilitetit të trafikut urban në Komunën e Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-10415  
Më 25.9.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 25.9.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të datës 10.9.2012, rreth lejimit të shpalljes së tenderit për ndërtimin e disa rrugëve lokale me elemente të betonit sipas praktikës së participimit, në Komunën e Prizrenit, dhe mori këtë:

### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 10.9.2012, rreth lejimit të ndërtimit të disa rrugëve lokale me elemente të betonit sipas praktikës së participimit, në Komunën e Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për ndërtimin e:

1. Rrugës “Gjirokastra”,
2. Murit mbrojtës në rrugën “Samidin Emini”,
3. Rrugës “Transit-Trepeticë”,
4. Rrugës në fshatin Landovicë,
5. Rrugëve lokale në lagjen “Bajram Curri”,
6. Rrugëve lokale në fshatin Lukinjë dhe
7. Rruga “Flamuri” -rrugë anësore;

Për realizimin e këtyre projekteve, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-10415  
Më 25.9.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.2.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, të datës 21.9.2012, rreth ndarjes së lokacionit për objektin Universitar – Universiteti i Prizrenit, dhe mori këtë

### K O N K L U Z I O N

U shqyrtua propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, të datës 21.9.2012, rreth ndarjes së lokacionit për Universitetin e Prizrenit, i cili gjendet në Planin Rregullativ “Boka” në mes të fshatit Korishë dhe Malësi e Re, në ngastrën kadastrore nr. 688-1 dhe 288 në sipërfaqe prej përafërsisht 8.5 ha, në ZK Lutogllavë, me qëllim të ndërtimit të objektit universitar –Universitetit të Prizrenit.

Ky propozim i procedohet Komisionit për Pronë, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe vendimmarrje.

Obligohet Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor që, pas marrjes së këtij konkluzioni, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa, në Komisionin e Pronës dhe Kuvendin e Komunës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrës.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrës, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-10415  
Më 25.9.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 25.9.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, të datës 17.9.2012, rreth lejit të shpalljes së tenderit për realizimin e projektit që ka të bëjë me trashëgiminë kulturore në Prizren, dhe mori këtë:

### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, i datës 17.9.2012, për lejitin e realizimit të projektit “Trashëgimia Kulturore-identifikimi i zejeve të vjetra, promovimi i tyre, shtypja e materialeve informative, organizimi i punëtorive, trajnimeve dhe për organizimin e panairit me artizanate të vjetra”, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-10415  
Më 25.9.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 25.9.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural rreth lejimit të shpalljes së ankandit publik për shitjen e masës drunore, e cila është konfiskuar nga autoritetet komunale pyjore, dhe mori këtë

### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural rreth lejimit tenderimit të masës drunore, e cila është konfiskuar nga autoritetet komunale pyjore gjatë periudhës janar-shtator 2012, kështu që lejohet shpallja e ankandit publik për shitjen e 66.55 m<sup>3</sup> dru dhe atë sipas specifikacionit të prezantuar.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-10415  
Më 25.9.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të datës 17.9.2012, bazuar në kërkesën e Shoqatës së Fermerëve të Deleve “Prosharri” rreth lejimit të mjeteve financiare, me qëllim të organizimit të manifestimit “ Dita e qethjeve të deleve -2012”, kryetari i Komunës më 25 shtator 2012, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i datës 17.9.2012, i bazuar në kërkesën e Shoqatës së Fermerëve të Deleve “Prosharri”, rreth lejimit të mjeteve financiare, me qëllim të organizimit të manifestimit të quajtur “ Dita e qethjeve të deleve -2012”, që organizohet me 28.9.2012 në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës, me Shoqatën së Fermerëve të Deleve “Prosharri” dhe blegtorëve të tjerë, kështu që për organizim e këtij manifestimi lejohen mjetet në shumën prej 2000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-10415  
Më 25.9.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Inspektorateve për formimin e Komisionit për verifikimin dhe vlerësimin e gjendjes faktike, të krijuar nga uji i ndotur i seperacioneve në ZK Tupec në vendin e quajtur “Livadhet e Egra”, kryetari i Komunës, më 25 shtator 2012, miratoi këtë:

#### A K T V E N D I M

I. Formohet dhe emërohet Komisioni për verifikimin dhe vlerësimin e gjendjes faktike, të krijuar nga uji i ndotur i seperacioneve në ZK Tupec, në vendin e quajtur “Livadhet e Egra”.

Për anëtarë të këtij komisioni, emërohen: 1. Agim Kolukaj, nga DI, 2. Hajrullah Hoxha, nga DBZHR, 3. Ramadan Tafallari nga DShP, 4. Ylber Gashi, nga DUPH, dhe Haziz Hodaj, përfaqësues i fshatit Gjonaj.

II. Detyrat e komisionit do të jenë: Të bëjë vlerësimin e gjendjes reale-faktike, të krijuar në pronat e qytetarëve në Zonën Kadastrorë Tupec në vendin e quajtur “Livadhet e Egra”, për shkak të mbylljes së kanalit nga uji i ndotur (lymi) i seperacioneve në këtë zonë. Obligohet komisioni që një afat sa më të shkurtër të del në terren dhe të ofrojë propozime konkrete për eliminimin e këtij problemi.

III. Komisioni, nga pika I e këtij Aktvendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me ligjin në fuqi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të këtij aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtoria e Inspektorateve dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen Drejtoria e Inspektorateve, të emëruarit dhe Arkivi.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-10415  
Më 25.9.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, të datës 17.9.2012, rreth lejimit të mjeteve financiare, për pagesë të trajnimit të zjarrfikësve nga ana e OJQ “Paqe, Prosperitet dhe Vlera”, kryetari i Komunës më 25 shtator 2012, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, i datës 17.9.2012, rreth lejimit të mjeteve financiare, me qëllim të pagesës së trajnimit të zjarrfikësve të Komunës së Prizrenit, nga ana e OJQ “Paqe, Prosperitet dhe Vlera”, kështu që për këtë qëllim dhe, në emër të trajnimit, lejohen mjetet në shumën prej 8.160 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-10415  
Më 25.9.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, të datës 17.9.2012, rreth lejimit të mjeteve financiare për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit për Muhamet Elshanin, zjarrfikës në Komunën e Prizrenit, kryetari i Komunës më 25 shtator 2012, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, i datës 17.9.2012, rreth lejimit të mjeteve financiare, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit për Muhamet Elshanin, zjarrfikës në Komunën e Prizrenit, i lënduar në vendin e punës, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjetet në shumën prej 300 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, i lartcekuri, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-10415  
Më 25.9.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, të datës 17.9.2012, rreth lejimit të mjeteve financiare, për rrënimin e murit në rr. “Ismet Jashari –Kumanova”-përballë ShFMU “Lidhja e Prizrenit”, kryetari i Komunës më 25 shtator 2012, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, i datës 17.9.2012, rreth lejimit të mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve lidhur me rrënimin e murit të dëmtuar, i cili gjendet në rrugën “Ismet Jashari –Kumanova”-përballë ShFMU “Lidhja e Prizrenit”, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjetet në shumën prej 300 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, i lartcekuri, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-10415

Më 25.9.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, të datës 19.9.2012, rreth përkrahjes financiare për organizimin e manifestimit “Ditët e Boshnjakëve” në Prizren, kryetari i Komunës më 25 shtator 2012, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, i datës 19.9.2012, i bazuar në kërkesën e OJQ “BSK” (Bosanski Savet Kosova) rreth përkrahjes financiare për shënimin dhe organizimin e manifestimit “Ditët e Boshnjakëve”, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën 2000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve dhe atë: 1000 € nga buxheti i Zyrës për Komunitete dhe Kthim dhe 1000 € nga buxheti i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Zyra për Komunitete dhe Kthim.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Zyra për Komunitete dhe Kthim, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-10415  
Më 25.9.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës –Zyra për Çështje Gjinore, të datës 21.9.2012, rreth anulimit të konkluzioni nr. 01/06-9249 të datës 23.8.2011 dhe dhënies në shfrytëzim të lokalit tjetër në pronësi të Komunës OJQ-së “Teuta”, kryetari i Komunës më 25 shtator 2012, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Anulohet Konkluzioni nr. 01/06-9249 i datës 23.8.2011, që ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim të lokalit, i cili gjendet në ngastrën kadastrore nr. 3340-0 në pronësi të Komunës OJQ-së “Teuta”.

### Neni 2

OJQ-së “Teuta” i jepet në shfrytëzim të përkohshëm lokali i cili gjendet te Tregu i Gjëlber në Ortakoll në LAM C, OCK 7 në pronësi të Komunës dhe atë me qira mujore prej 1 €.

### Neni 3

Lejohet shpallja e tenderit për renovimin dhe riparimin e lokalit të cekur si në nenin 2 të këtij vendimi. Mjetet për riparimin e këtij lokalit, do të sigurohen nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve i Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

### Neni 4

Obligohet Drejtoria e Administratës - Sektori i Pronës që të përpilojë kontratën mbi dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të lokalit-zyrës së lartcekur sipas nenit II të këtij vendimi OJQ-së “Teuta”.

### Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës –Zyra për Çështje Gjinore, Sektori i Pronës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

### Neni 6

Me këtë Vendim të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës – Zyra për Çështje Gjinore, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Pronës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

### Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-10415  
Më 25.9.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 25.9.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e rreth miratimit të Draftregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e mjeteve nga buxheti i Komunës- pozicioni i subvencioneve, dhe mori këtë:

#### K O N K L U Z I O N

I. U shqyrtua Draftregullorja për caktimin e kriterëve për ndarjen e mjeteve nga buxheti i Komunës- pozicioni i subvencioneve.

II. Obligohet Komisioni i cili ka bërë Draftregulloren për caktimin e kriterëve për ndarjen e mjeteve nga buxheti i Komunës- pozicioni i subvencioneve që, pas marrjes së këtij konkluzioni, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen kryetari i komisionit, dhe drejtoritë komunale.

Me këtë konkluzion të njoftohen kryetari i komisionit, drejtoritë komunale, KPF-ja, Kuvendi i Komunës, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Prizrenit  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-10415  
Më 25.9.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të datës 25.9.2012, rreth përkrahjes financiare për AAKV “Emin Duraku” nga Zhuri me qëllim të pjesëmarrjes në Festivalin Ballkanik të Folklorit që mbahet në Izmir të Republikës së Turqisë, kryetari i Komunës më 25 shtator 2012, miratoi këtë:

V E N D I M  
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 25.9.2012, rreth lejimit të mjeteve për përkrahje për AAKV “Emin Duraku” nga Zhuri, me qëllim të pjesëmarrjes në Festivalin Ballkanik të Folklorit që mbahet nga data 4-11 tetor 2012 në Izmir të Republikës së Turqisë, kështu që, në emër të përkrahjes financiare, lejohen mjetet financiare në shumën prej 2000 €

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, AAKV “Emin Duraku” si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja